



Strasbourg, 17 nëntor 2010

CCJE (2010)3 Final

## KËSHILLI KONSULTATIV I GJYQARËVE EVROPIAN

### (KKGJE)

*Për shkak të një inkohërence midis versionit të gjuhës angleze dhe asaj frënge e vënë në pah nga disa anëtarë KKGJE-së dhe për të pasur koherencë më të mirë me Opinionin Nr. 3 të KKGJE-së (paragrafi 57), Sekretariati ka ndryshuar më parë paragrafin 22 të Magna Cartas siç është miratuar zyrtarisht nga KKGJE-ja në nëntor të vitit 2010. Pas takimit të fundit të Byrosë (mars 2011), është vendosur që të kthehet në këtë version. **Prandaj, kërkohet nga çdo Përdorues që të verifikoj se paragrafi 22 i Magna Cartas i përdorur që atëherë korrespondon me tekstin e bashkëngjitur.***

### MAGNA CARTA E GJYQARËVE (Parimet Themelore)

#### Hyrje:

*Me rastin e 10-vjetorit të saj, KKGJE-ja në mbledhjen e saj të 11-të plenar (Strasbourg, 17-19 nëntor 2010), miratoi një Magna Carta të Gjyqtarëve (Parimet themelore) që përmbledhë dhe kodifikon përfundimet kryesore të Opinioneve që ajo i kishte miratuara. Secili prej këtyre 12 Opinioneve, paraqitur para Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, përmban shtjellime shtesë mbi temat e trajtuara në këtë dokument (shih [www.coe.int/ccje](http://www.coe.int/ccje)).*

## **MAGNA CARTA E GJYQTARËVE (Parimet Themelores)**

### **Sundimi i ligjit dhe drejtësia**

1. Gjyqësori është një nga tre autoritetet e çdo shteti demokratik. Misioni i tij është që të garantoj vetë ekzistencën e Sundimit të Ligjit dhe në këtë mënyrë, që të siguroj zbatimin e duhur të ligjit në mënyrë të paanshme, të drejtë, të ndershme dhe efikase.

### **Pavarësia e Gjyqësorit**

2. Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë.

3. Pavarësia e gjyqësorit duhet të jetë statusore, funksionale dhe financiare. Ajo duhet të jetë e garantuar sa i përket autoriteteve tjera të shtetit, për ata që kërkojnë drejtësi, gjyqtarët e tjerë dhe shoqërinë në përgjithësi, me anë të rregullave kombëtare të nivelit më të lartë të mundshëm. Shteti dhe çdo gjyqtar janë përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

4. Pavarësia e gjyqësorit duhet të jetë e garantuar sa i përket aktiviteteve gjyqësore dhe në mënyrë të veçantë sa i përket rekrutimit, emërimit deri në moshën e daljes në pension, promovimit, pandërrueshmërisë, trajnimit, imunitetit gjyqësor, disiplinës, pagesës dhe financimit të gjyqësorit.

### **Garancitë e pavarësisë**

5. Vendimet për përzgjedhjen, emërimin dhe karrierën duhet të bazohen në kriteret objektive dhe ato duhet të merren nga organi përgjegjës për garantimin e pavarësisë.

6. Procedurat disiplinore duhet të merren para një organi të pavarur me mundësi të adresimit të tyre përpara një gjykate.

7. Pas konsultimit me gjyqësorin, Shteti duhet të siguroj burimet njerëzore, materiale dhe financiare të nevojshme për funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë. Për të shmangur ndikim të paligjshëm, gjyqtarët duhet të marrin pagesë të përshtatshme dhe të pajisen me një skemë të përshtatshme të pensioneve, që rregullohet me ligj.

8. Trajnimi fillestar dhe në shërbim është një e drejtë dhe një detyrë për gjyqtarët. Trajnimi duhet të organizohet nën mbikëqyrjen e gjyqësorit. Trajnimi është një element i rëndësishëm për të ruajtur pavarësinë e gjyqtarëve, si dhe cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor.

9. Gjyqësori duhet të jetë i përfshirë në të gjitha vendimet të cilat ndikojnë në praktikën e funksioneve gjyqësore (organizimi i gjykatave, procedura, ligje të tjera).

10. Në ushtrimin e funksionit të tyre në drejtësi, gjyqtarët nuk duhet t'iu nënshtrohen ndonjë urdhri apo udhëzimi, ose ndonjë presioni hierarkik, dhe duhet t'i nënshtrohen vetëm ligjit.

11. Gjyqtarët duhet të sigurojnë barazinë në mes të prokurorisë dhe mbrojtjes. Statusi i pavarur i prokurorëve është një kërkesë themelore për Sundimin e Ligjit.

12. Gjyqtarët kanë të drejtë të jenë anëtarë të shoqatave kombëtare ose ndërkombëtare të gjyqtarëve, të ngarkuara me mbrojtjen e misionit të gjyqësorit në shoqëri.

## **Organi përgjegjës për garantimin e pavarësisë**

13. Për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve, çdo shtet duhet të krijoj një Këshilli Gjyqësor apo ndonjë organi tjetër të caktuar, Këshill ky i pavarur nga fuqitë legjislative dhe ekzekutive, të pajisura me kompetenca të gjera sa i përket të gjitha pyetjeve në lidhje me statusin e tyre si dhe me organizimin, funksionimin dhe imazhin e institucioneve gjyqësore. Këshilli duhet të përbëhet ekskluzivisht nga gjyqtarët ose nga një shumicë e konsiderueshme e gjyqtarëve të zgjedhur nga kolegët e tyre. Këshilli Gjyqësor duhet të jetë përgjegjës për aktivitetet dhe vendimet e tij.

## **Qasja në drejtësi dhe transparencë**

14. Drejtësia duhet të jetë transparente dhe informacioni duhet të publikohet në funksionimin e sistemit gjyqësor.

15. Gjyqtarët duhet të marrin masa për të siguruar qasje të shpejtë, efikase dhe të përballueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; ata duhet të kontribuojnë në promovimin e metodave alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

16. Dokumentet e gjykatës dhe vendimet gjyqësore duhet të hartohen në një gjuhë të kuptueshme, të thjeshtë dhe të qartë. Gjyqtarët duhet të nxjerrin vendime të arsyetuara, të shpallura publikisht brenda një kohe të arsyeshme, bazuar në gjykim të drejtë dhe publik. Gjyqtarët duhet të përdorin metoda të përshtatshme të menaxhimit të lëndëve.

17. Zbatimi i urdhrave të gjykatës është një komponent thelbësor i të drejtës për gjykim të drejtë dhe gjithashtu një garanci e efikasitetit të drejtësisë.

## **Etika dhe përgjegjësia**

18. Parimet deontologjike, të dalluara nga rregullat disiplinore, duhet të udhëheqin veprimet e gjyqtarëve. Ato duhet të hartohen nga vetë gjyqtarët dhe të përfshihen në trajnimin e tyre.

19. Në çdo Shtet, statuti ose akti themelues i aplikueshëm për gjyqtarët duhet të përcaktoj sjelljet e pahijshme që mund të çojnë në sanksione disiplinore, si dhe në procedurë disiplinore.

20. Gjyqtarët duhet të jenë përgjegjës penalisht sipas ligjit të zakonshëm për shkelje të kryera jashtë funksionit të tyre gjyqësor. Përgjegjësia penale nuk duhet të bie mbi gjyqtarët në rast të dështimeve të paqëllimshme në ushtrimin e funksioneve të tyre.

21. Korrigjimi i gabime gjyqësore duhet të qëndrojë në një sistem të përshtatshëm të ankesave. Çdo mjet tjetër për korrigjim të dështimeve tjera në administrimin e drejtësisë qëndron vetëm kundër shtetit.

22. Nuk është e përshtatshme që një gjykatës të ekspozohet ndaj ndonjë detyrimi personal, në lidhje me ushtrimin e funksioneve gjyqësore të nënkuptuara, madje edhe me anë të rimbursimit të shtetit, përveç në rast të mospërbushjes së obligimit me dëshirë.

## **Gjykatat ndërkombëtare**

23. Këto parime duhet të zbatohen *mutatis mutandis* për gjyqtarët e të gjitha gjykatave evropiane dhe ndërkombëtare.

<sup>(1)</sup> Për shkak të një inkoherece midis versionit të gjuhës angleze dhe asaj frënge e vënë në pah nga disa anëtarë KKGJE-së dhe për të pasur koherencë më të mirë me Opinionin Nr. 3 të KKGJE-së (paragrafi 57), Sekretariati ka ndryshuar më parë paragrafin 22 të Magna Cartas siç është miratuar zyrtarisht nga KKGJE-ja në nëntor. Pas takimit të fundit të Byrosë (mars 2011), është vendosur që të kthehet në këtë version. **Prandaj, kërkohet nga çdo Përdorues që të verifikoj se paragrafi 22 i Magna Cartas i përdorur që atëherë korrespondon me tekstin e bashkëngjitur.**